

# Auditim i listës së votuesve të Kaçanikut

Mostër për Kosovën



Democracy for Development  
Demokraci për zhvillim  
Demokratija za razvoj



---

# **Auditim i listës së votuesve të Kaçanikut**

**Mostër për Kosovën**

Leon Malazogu, Visar Sutaj dhe Drilon Gashi

Prishtinë, nëntor 2012

---

Copyright © 2012. Demokraci për Zhvillim (D4D).

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç për citim të pjesëve të shkurtra për qëllime të kritikave apo vlerësimeve, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme ripërtëritëse, ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjet elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistrues etj., pa lejen me shkrim të D4D-së.

Përgatitur nga:

Leon Malazogu, Visar Sutaj dhe Drilon Gashi

Verifikimi dhe auditimi i listës së votuesve është financuar nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës përderisa analiza e të dhënave është bërë e mundur nga projekti “Për përfaqësim të vërtetë në Kosovë” për reformë zgjedhore, i financiar nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrës. Përmbajtja e këtij raporti është në tërësi përgjegjësi e D4D-së.

---

## **Përmbajtja**

Përmbledhje, 5

Hyrje, 7

Metodologjia e hulumtimit, 9

Konteksti, 12

Votuesit nga komunat tjera, 13

Sa votues aktualisht jetojnë në Kaçanik?, 15

Sa i rëndësishëm është problemi?, 18

Përmbledhja kryesore, 19

Votuesit e peregjistruar, 21

Rezultatet e filtruara, 22

Saktësia e madhe në listë të votuesve tregon dalje më të lartë  
në zgjedhje, 29

Përfundim dhe rekomandime, 32

-----

-----

## Përmbledhje

Hulumtimi intensiv në terren i kryer nga Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D) në komunën e Kaçanikut ka matur shkallën e saktësisë së listës së votuesve të komunës. Më saktësisht, kërkimi ka matur shkallën në të cilën personat nga lista e votuesve mund të votojnë aty ku e gëzojnë të drejtën e votës.

Auditimi i listës së votuesve të Kaçanikut tregoi se vetëm 60% e emrave të votuesve të regjistruar jetojnë në lokalitetet ku figurojnë emrat e tyre. Të tjerët ose jetojnë jashtë vendit (19%), janë të vdekur (3%), jetojnë në një vendndodhje tjetër në Kosovë (11%) apo nuk ka pasur informata për ta (7%).

Një listë e tillë e votuesve nuk është e besueshme dhe nuk mundëson zgjedhje të drejta. Supozimi është se problemet me pasaktësinë e listës së votuesve në Kosovë janë tejet të përhapura.

Ekziston pra një sfidë e dyfishtë për autoritetet relevante. Organet e menaxhimit të zgjedhjeve duhet të kufizojnë manipulimet e procesit zgjedhor, duke parandaluar votimin në emër të dikujt tjetër. Pa një proces të mirëfilltë, listat e dobëta të votuesve e bëjnë të mundshme votimin në emër të dikujt tjetër. Ministria e Punëve të Brendshme duhet të rregullojë në mënyrë sistematike procesin dhe të organizojë të gjitha institucionet që kanë përgjegjësi për ofrimin e të dhënave dhe mirëmbajtjen e regjistrit civil, për të siguruar që Kosova ka të dhëna të sakta dhe të përditësuar të popullatës dhe të vendbanimeve.

Tri probleme duhet të zgjidhen menjëherë, edhe para se të arrihet një qasje sistematike në zgjidhjen e këtij problemi. Burimi kryesor i pasaktësisë janë personat që kanë vetëm dokumente të UNMIK-ut dhe asnjëherë nuk kanë marrë dokumente të Kosovës. Problemi gjithashtu është më i

theksuar tek te moshuarit, gjë që është tregues se personat për të cilët nuk ka informata sigurisht gjinden në kategorinë e të vdekurve.

Ky punim rekomandon që: (a) të rishikohet procesi i mirëmbajtjes së regjistrit civil, (b) emrat e votuesve nga diaspora duhet të mbahen në një listë tjetër të votuesve, dhe (c) duhet të ketë zbatim më të mirë dhe rritje të ndërgjegjësimit për sa i përket përgjegjësisë ligjore për përditësimin e adresave të banimit.



## Hyrje

Posedimi i një liste të saktë të votuesve është një parakusht i rëndësishëm për zgjedhje të lira, të drejta. Ankesa për pasaktësi të listës së votuesve janë ngritur vazhdimisht në Kosovë, para dhe pas çdo procesi zgjedhor.

Ky raport prezanton rezultatet e një auditimi të listës së votuesve të Kaçanikut të bërë së fundmi me qëllim që të matet niveli i pasaktësive dhe parregullsive. Gjithashtu, raporti paraqet rekomandime për të adresuar ato.

Lista e votuesve krijohet nga ekstrakti i regjistrimit civil i krijuar dhe i mirëmbajtur nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB). Baza e të dhënave të regjistrimit civil përfshin të gjithë qytetarët e pajisur me letërnjoftime, që u lëshohen qytetarëve të moshës mbi 16 vjeçare nga Departamenti i Dokumenteve Publike (DDP).

Praktika e rregullt është që për çdo cikël të zgjedhjeve MPB-ja i ofron Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) një ekstrakt të fundit të regjistrimit civil të të gjithë votuesve të moshës mbi 18 vjeç. Kjo do të thotë që lëshimet në listën e votuesve tërësisht reflektojnë lëshimet në regjistrin civil, prandaj që përmirësimet duhet të bëhen në të dytën.

Për të bërë auditimin, Demokracia për Zhvillim (D4D) mbledhi një ekip prej 17 verifikuesve të cilët gjatë muajit maj dhe qershor të vitit 2012 shkuan derë më derë në tërë komunën e Kaçanikut. Të pajisur me listën e fundit të votuesve për secilën qendër të votimit, ata verifikuan nëse personat e gjetur në shtëpitë të cilat ata kanë vizituar janë të përfshirë në listën e votuesve.

Përderisa Kaçaniku mund të jetë vetëm një rast, ky punim dhe të gjeturat e tij mund të përdoren ose si të dhëna mostër për tërë Kosovën, ose për të organizuar auditime të ngjashme në komuna tjera. Një listë më e saktë e votuesve

në tërë Kosovën mundet të përmirësojë në masë të madhe procesin e votimit dhe të zvogëlojë mundësitë për manipulime në kuti të votimit.

Duhet të theksohet se ka pasur dëshmi për probleme madhore edhe para auditimit. Një shembull dallues është që ish-presidenti i Kosovës dhe ndoshta figura më e njohur publike në Kosovë në dy dekadat e fundit, Ibrahim Rugova, akoma gjendej në listë të votuesve disa vite pas vdekjes së tij. Disa raporte tjera, përfshirë një të shkruar më herët nga një autor që tani është me D4D-në, ka nxjerrë në pah parregullsi që në mungesë të të dhënave shpesh janë trajtuar vetëm si spekulime.

## Metodologjia e hulumtimit

Qëllimi i këtij studimi ishte verifikimi i sa më shumë emrave që janë në listën e votuesve në komunën e Kaçanikut, derë më derë. Studimi është përpjekur të vlerësojë numrin e votuesve që aktualisht jetojnë në zonën ku e kanë emrin për të votuar. Numri i personave aktual është krahasuar kundrejt pjesës së votuesve që jetojnë jashtë vendit, kanë vdekur apo kanë lëvizur në komuna tjera. Realizimi i auditimit të listës së votuesve ka përfshirë një vlerësim paraprak të listës së votueseve, një program trajnues dhe punë në terren. Për këtë qëllim, D4D krijoi një ekip prej 17 verifikuesve të terrenit dhe një ekspert të bazës së të dhënave.

### *Hapi 1: Kontrollimi paraprak dhe verifikimi*

Para fillimit të hulumtimit në terren, D4D bëri një analizë preliminare të listës së votuesve për të identifikuar pasaktësitë e dukshme të cilat kërkonin pastrim teknik. Për verifikim u shfrytëzua lista më e fundit e cila ishte përdorur në zgjedhjet për kryetar komune në vitin 2012. Madhësia e vogël e Kaçanikut dhe disponueshmëria e listës më të fundit të votuesve ishin arsye kryesore pse Kaçaniku u zgjodh për këtë auditim.

Lista e votuesve u integrua në një aplikacion softuerik, i dizajnuar për dy qëllime: (1) gjenerimin e një pyetësoi për listën e votuesve për secilin lokacion, dhe (2) futjen e të dhënave. Listat ishin shtypur për secilin verifikues, ku secilit prej tyre i ishte dhënë deri në pesë fshatra për t'i mbuluar. Softuerë është përdorur për të analizuar të dhënat duke filtruar sipas disa kategori të votuesve, (a) personat të cilët nuk kanë marrë letërnjoftim të Kosovës dhe kanë vetëm të UNMIK-ut, dhe (b) votuesit më të vjetër se 70 vjeçar në ditën kur ishin gjeneruar raportet.

Supozimi themelor ishte se shumica e qytetarëve të Kosovës zotërojnë dokumente identiteti të Kosovës. Kaçaniku historikisht nuk ka pasur komunitete pakicë, prandaj mund të supozohet që personat të cilët nuk i kanë marrë letërnjoftimet e reja mund ta kenë lëshuar vendin apo të kenë vdekur. Emrat e këtyre dy kategorive ishin nënvizuar dhe verifikuesit ishin udhëzuar që të kenë vëmendje shtesë për këto dy kategori, si potencialisht më problematiket.

## ***Hapi 2: Trajnimi***

D4D zhvilloi një trajnim gjithëpërfshirës duke përfshirë doracak të trajnimeve, modele të pyetësorëve dhe udhëzime të përpikta për punën në terren. Verifikuesit morën udhëzime të hollësishme mbi mënyrën se si t'i qasen familjeve dhe si t'i mbledhin informacionet për familjet të cilat refuzojnë të përgjigjen apo për shtëpitë ku nuk banonte askush. Verifikuesit ishin inkurajuar që të mbledhnin informacione nga fqinjët pas shterrjes së mënyrave tjera për mbledhjen e informacioneve (nëse nuk kanë arritur që të flasin me anëtarë të familjes). Një periudhë testuese u shfrytëzua dhe pyetësi u finalizuar për përdorim përfundimtar.

## ***Hapi 3: Puna në terren***

Pas trajnimit dhe verifikimit paraprak, ekipi i verifikuesve zbarkoi në të gjithë komunën për të kryer verifikimin duke krahasuar të gjeturat aktuale kundrejt listës së votuesve. Kjo pjesë kryesore e hulumtimit mori dy javë për të përfunduar. Verifikuesit u caktuar për zonat që ata i njihnin më mirë. Pas një vazhdimi për një javë për disa pjesë, verifikuesit arritën të mbulojnë pothuajse çdo shtëpi në lokalitetet e tyre përkatëse. Verifikuesit kishin për detyrë që të verifikojnë informacionet për votuesit duke shënuar statusin e secilit individ siç shihet në tabelën e prezantuar më poshtë.

### Pjesë e skenuar nga formulari

Numri	Mbiemri	Emri	Data lindja	Këtë Adresë/ Fshat	Tjetër Adresë/ Fshat	Jashtë Kaçanikut / Brenda Kosovës	Jashtë Kosovës	I/e Vdekur
530	GASHI		1/4/1933	X				
531	GASHI		1/28/1933					X
532	GASHI		7/14/1985	X				
533	GASHI		9/15/1991	X				
534	GASHI		2/9/1993	X				
535	GASHI		5/31/1963	X				
536	GASHI		9/15/1962				X	
537	GASHI		3/21/1967				X	
538	GASHI		6/10/1963				X	
539	GASHI		11/20/1986	X				
540	GASHI		4/16/1947	X				

Formularët korrespondojnë me bazën e të dhënave dhe secili votues u kategorizua në një prej kategorive vijuese:

- Kolona e pestë: Jeton në të njëjtën vendndodhje;
- Kolona e gjashtë: Jeton në një tjetër vendndodhje brenda Kaçanikut;
- Kolona e shtatë: Ka lëvizur në tjetër komunë të Kosovës;
- Kolona e tetë: Jeton jashtë vendit (është pjesë e diasporës jashtë Kosovës);
- Kolona e nëntë: I/e vdekur.

Kur verifikuesit nuk mund të gjenin emrin e ndonjë personi në listën e votuesve, ata e regjistrojnë emrin e tyre të plotë dhe datën e lindjes.

## Konteksti

Kaçaniku ka gjithsej 16 qendra votimi, dy nga të cilat gjenden në qytezë (0701D dhe 0702X) dhe të tjerat në fshatra.

Njëzet e tetë fshatra të Kaçanikut përbëjnë gati 70% të popullatës së komunës. Madhësia e fshatrave ndryshon për nga territori dhe numri i votuesve. Fshatrat me madhësi të madhe dhe mesatare zakonisht kanë qendrat e tyre të votimit. Përjashtim bëjnë fshatrat Bob, Runjevë dhe Llanishtë, të cilat kanë numër të madh të votuesve, janë caktuar që të votojnë në dy qendrat e votimit në qytetin e Kaçanikut për shkak të afërsisë me qytezën. Shumica e fshatrave të vogla nuk kanë vendvotime dhe votuesit duhet të udhëtojnë.

Ka dhjetë fshatra të mëdha, me më tepër se një mijë votues që përfshijnë: Vatë/Dubravë (2.197 votues), Begracë (1.801 votues), Kaçanik i Vjetër (1.551 votues), Gllaboçicë (1.437 votues), Bob (1.410 votues), Biqec (1.390 votues), Doganaj (1.307 votues), Stagovë (1.189 votues), Kovaçec (1.049 votues) dhe Soponicë (1.034 votues). Gati çdo fshat ka qendrën e votimit ku banorët e tyre apo edhe votues nga fshatrat e vogla përreth votojnë.

Janë pesë fshatra me madhësi mesatare, me 500 deri në 1.000 votues: Nikaj (772 votues), Ivajë (701 votues), Runjevë (650 votues), Rekë (599 votues) dhe Kotlinë (598 votues). Me më pak se 500 votues janë 14 fshatra: Gajre (489 votues), Bajnicë (415 votues), Strazhë (364 votues), Gabricë (398 votues), Gërlicë e Epërme (363 votues), Gjurgjedell (336 votues), Elezaj (327 votues), Sllatinë (271 votues), Gabricë e Epërme (270 votues), Korboliq (189 votues), Semajë (184 votues), Drenogllavë (135 votues) dhe Nikovc (9 votues).

## Votuesit nga komunat tjera

Lista e votuesve e përdorur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) kishte 31.474 votues të regjistruar. Vlerësimi paraprak i listës së votuesve tregon se ka votues nga komunat tjera dhe votues të panjohur të regjistruar. Tabela më poshtë paraqet zbërthimin e numrit të votuesve që duhej të hiqeshin nga lista fillimit të punës në terren. Dukej qartë që nuk kanë të bëjnë me Kaçanikun dhe se nuk mund të gjenden në këtë komunë.

Komuna	Votues
Ferizaj	233
Viti	32
Hani i Elezit	28
Prishtinë	27
Shtërpcë	13
Lipjan & Shtime	17
Gjilan & Kamenicë	9
Deçan & Pejë	7
Suharekë & Podujevë	6
Mitrovicë & Vushtrri	4
Istog & Klinë	4
Drenas & Skenderaj	2
Fushë Kosovë & Obiliq	2
Shkup	1
Prizren & Gjakovë	2
Paqartë	33
<b>Totali</b>	<b>420</b>

Vlerësimi i parë paraprak i listës së votuesve tregoi se 387 votues të regjistruar në Kaçanik ishin nga komunat tjera.

Është shumë e vështirë të vlerësohet pse ka ndodhur kjo parregullsi. Megjithatë, duke e konsideruar se Ferizaj është komuna më e afërt me Kaçanikun, mund të ndodhë që këta votues ose të kenë lëvizur për në Kaçanik apo kanë dalë nga aty.

Siç shihet në tabelë, më tepër se 60% e votuesve nga komunat tjera janë nga Ferizaj. Por nuk është e qartë se si janë në listë e nuk janë fare të regjistruar në komunë të Kaçanikut.

<b>Totali i emrave në listën e votuesve të KQZ-së</b>	<b>31.474</b>
Minus emrat nga komunat tjera të përfshira gabimisht në listën e votuesve	420
<b>Lista e pastruar e targetuar nga hulumtimi në terren</b>	<b>31.054</b>

Për më tepër, 33 votues vendbanimi i të cilëve ishte tërësisht i panjohur është deshur që të largohen nga lista para se të bëhej auditimi. Gjithsej 420 (1,3%) emra ishin larguar nga lista para se të shkonin verifikuesit në terren. Numri total i votuesve që u ruajtën në listë për verifikim në terren ishte 31.054.



## Sa votues aktualisht jetojnë në Kaçanik?

Puna në terren është menaxhuar nga 16 verifikues dhe një koordinator i terrenit. Qëllimi i tyre ishte që të arrijnë tek sa më shumë banorë që të jetë i mundur në mënyrë që të verifikohet totali i pastruar prej 31.054 votuesish. Verifikuesit arritën që të marrin informacione për 28,916 votues (duke mbuluar 93% të numrit total). Zbërthimi i përgjithshëm jep shifrat në vijim:

<b>Lista e pastruar e targetuar nga hulumtimi në terren</b>	<b>31.054</b>	
- Të gjetur në vendndodhje sikurse ai në listë të votuesve	18.662	60%
- Tjetër fshat/qytezë Brenda Kaçanikut	1.939	6%
- Në një komunë tjetër Brenda Kosovës	1.406	5%
- Jashtë Kosovës	6.051	19%
- Të vdekur	858	3%
- Nuk ka informata	2.141	7%

### ***Të gjetur në lokalitete sikurse në listë të votuesve***

Të dhënat e hulumtimit tregojnë se më shumë se 60% të votuesve të regjistruar në Kaçanik (18.662) jetojnë në të njëjtin vendbanim siç i tregon edhe lista e votuesve. Disa nga fshatrat kanë saktësi deri në 81% (fshati Nikaj, për shembull), dhe ka fshatra me saktësi shumë të ulët si në Drenogllavë ku saktësia është vetëm 18%. Duhet të theksohet që saktësia tregon vetëm nivelin e saktësisë në nivel të fshatit/qytetit dhe jo për adresa të veçanta apo për lagje.

## ***Votuesit nga tjetër fshat/vend në Kaçanik***

Numri total i votuesve që jetojnë në adresë apo fshat tjetër brenda komunës së Kaçanikut është 1.939 (pak mbi 6%). Niveli më i lartë i migrimit brenda komunës ka qenë nga fshati Ivajë (28%), përderisa ka pasur fshatra me migrim të vogël (deri në 1%).

## ***Votuesit nga komunat tjera në Kosovë***

Të gjeturat e hulumtimit tregojnë që pak më shumë se 4% e votuesve të regjistruar në Kaçanik (1.406) jetojnë në një komunë tjetër. Emrat e këtyre votuesve janë konfirmuar se të njëjtit kanë lëvizur apo jetojnë në komuna tjera të Kosovës (e përkufizuar se jetojnë jashtë komunës më shumë se gjysmën e kohës). Numri më i madh i votuesve që kanë migruar në zona tjera brenda Kosovës janë nga fshatrat Drenogllavë (59%) dhe Korboliq (28%), përderisa niveli më i ulët në fshatrat Gabricë, Rekë dhe Runjevë (rreth 1%).

## ***Votuesit që jetojnë jashtë Kosovës***

Më shumë se 19% të votuesve të regjistruar në Kaçanik (6.501) jetojnë jashtë Kosovës. Niveli më i lartë i migrimit jashtë Kosovës është regjistruar në fshatrat Glloboçicë dhe Korboliq (të dyja fshatrat kanë nga 37%). Shkalla më e ulët e votuesve që jetojnë jashtë Kosovës ka qenë në Nikaj (9%) dhe Ivajë (12%). Qyteza e Kaçanikut ka po ashtu një nivel të madh të votuesve që jetojnë jashtë vendit, përafërsisht 17%.

## ***Votuesit e vdekur***

Afër 3% të votuesve në listën e votuesve në Kaçanik (857) është theksuar nga të afërmit se kenë të vdekur. Të vdekurit akoma shpesh janë të përfshirë në listën e votuesve sepse anëtarët e familjes nuk raportojnë rregullisht rastet e vdekjes tek Zyra e Statusit Civil në komunë. Si rezultat, vdekjet nuk raportohen edhe në Regjistrin Civil Qendror në

Ministrinë e Punëve të Brendshme. Numri më i madh i votuesve të regjistruar të vdekur është gjetur në fshatin Gjurgjedell (6%). Fshatrat tjera me numër të madh të votuesve të vdekur—me rreth 4% — përfshin fshatrat Bob, Drenogllavë, Elezaj, Gërlinë e Epërme, Kotlinë dhe Nikaj. Numri më i ulët i emrave të votuesve të vdekur ka qenë në fshatin Strazhë (1%).

### ***Pa informata***

Verifikuesit nuk kanë mundur të mbledhin informata të sakta për 2.071 votues sepse të anketuarit apo banorët që janë intervistuar nuk kanë pasur informata në lidhje me votuesit e regjistruar. Rreth një e treta e tyre ishin në qytezën e Kaçanikut. Këta votues sipas të gjitha gjasave i bien në kategoritë e të vdekurve apo të atyre që jetojnë jashtë vendit.

## Sa i rëndësishëm është problemi?

Me qëllim për të ilustruar nivelin e problemit të kategorive më lartë, kemi grupuar në tri kategori. Kategoria më problematike (të vdekurit, ata që jetojnë jashtë vendit, votues pa informata) janë dalluar me ngjyrë të kuqe dhe me këtë ngjyrë përshkruhen përgjatë tërë raportit.

### **E saktë** (e gjelbër)

- Votues që janë gjetur në të njëjtin qytet/fshat si në Listën e Votuesve

### **Disi problematike** (e verdhë)

- Votues që kanë lëvizur brenda komunës së Kaçanikut apo në një komunë tjetër brenda Kosovës

### **Problematike** (e kuqe)

- Emra të votuesve që kanë migruar jashtë vendit, janë të vdekur, apo për të cilët nuk ka informata

Figura më poshtë tregon që 29% (të tre grupet së bashku) të votuesve bien në këtë kategorinë 'problematike'. Rreth 11% të votuesve të regjistruar bien në kategorinë 'disi problematike'—këta janë votuesit që kanë lëvizur brenda komunës së Kaçanikut (6%, e nënvizuar me të verdhë). Pjesa e nënvizuar me të gjelbër paraqet shumicën, 60%, që ishin votuesit e gjetur në qytet/ fshat sikurse në listën e votuesve.


Tabela pas grafikës paraqet ofron një zbërthim të rezultateve të hollësishtme për secilin fshat.

## Përmbledhja kryesore

---

### Zbërthimi i votuesve

---



# Mostër për Kosovën

Nr	Fshat/graçë	Lokali të si në listë të votuesve	Tjetër lokalitet	Tjetër komunë	Jashtë Kosovës	Të vdekur	Nuk ka informata	Të parregjistruar	Totali					
1	Bajnicë	251	6	43	73	8	34	4	415					
2	Begracë	1,273	33	138	256	36	65	44	1,801					
3	Bilçec	768	118	51	329	47	87	78	1,390					
4	Bob	918	109	40	237	52	44	14	1,410					
5	Doganaj	852	50	48	270	41	46	0	1,307					
6	Drenogllavë	24	0	80	59%	5	4%	9	7%	3	135			
7	Ellezaj	206	12	4%	14	4%	56	17%	14	4%	25	8%	10	327
8	Gabriçë	205	12	3%	4	1%	146	37%	13	3%	18	5%	7	398
9	Gabriçë e Epërme	127	7	3%	6	2%	100	37%	9	3%	21	8%	1	270
10	Gajre	257	61	12%	44	9%	89	18%	17	3%	21	4%	1	489
11	Gëriçë e Epërme	217	9	2%	23	6%	69	19%	14	4%	31	9%	25	363
12	Gjurgjedell	150	27	8%	23	7%	104	31%	19	6%	13	4%	0	336
13	Glibocqë	645	20	1%	46	3%	537	37%	32	2%	157	11%	0	1,437
14	Ivajë	293	196	28%	30	4%	86	12%	23	3%	73	10%	0	701
15	Kaçaniku i Vjetër	1,054	73	5%	63	4%	198	13%	41	3%	122	8%	2	1,551
16	Korbollq	46	7	4%	52	28%	70	37%	6	3%	8	4%	0	189
17	Kotlinë	225	46	8%	32	5%	91	15%	24	4%	180	30%	0	598
18	Kovaçecë	627	35	3%	22	2%	255	24%	31	3%	79	8%	113	1,049
19	Nikaj	624	11	1%	23	3%	70	9%	29	4%	15	2%	0	772
20	Nikovc	4	2	22%	0	0%	1	11%	0	0%	2	22%	0	9
21	Rekë	451	25	4%	5	1%	91	15%	20	3%	7	1%	0	599
22	Runjëvë	414	52	8%	7	1%	78	12%	12	2%	87	13%	19	650
23	Semajë	111	9	5%	15	8%	32	17%	3	2%	14	8%	7	184
24	Shtatë	90	25	9%	86	32%	48	18%	13	5%	9	3%	0	271
25	Soponitë	659	36	3%	45	4%	221	21%	33	3%	40	4%	2	1,034
26	Stagovë	711	43	4%	70	6%	193	16%	30	3%	142	12%	24	1,189
27	Strahë	174	17	5%	16	4%	100	27%	5	1%	52	14%	3	364
28	Vata Dubravë	1,206	119	5%	112	5%	630	29%	74	3%	56	3%	2	2,197
29	Kaçanik	6,080	779	8%	268	3%	1,604	17%	207	2%	684	7%	139	9,622
<b>Total</b>		<b>18,662</b>	<b>1,939</b>	<b>6.2%</b>	<b>1,406</b>	<b>4.5%</b>	<b>6,051</b>	<b>19.5%</b>	<b>858</b>	<b>2.8%</b>	<b>2,141</b>	<b>6.9%</b>	<b>498</b>	<b>31,057</b>

## Votuesit e paregjistruar

Verifikuesit e kishin për detyrë që të regjistrojnë votuesit që i kishin hasur gjatë punës në terren e që emri i tyre nuk mund të gjendej në listën e votuesve.

Gjithsej, verifikuesit hasën në 650 persona të tillë. Megjithatë, kur verifikuesit rishikuan emrat e këtyre votuesve me listat votuese të kolegëve të tyre në lokalitete të tjera në Kaçanik, afër një e katërta e tyre u gjetën si banorë të regjistruar në fshatra tjera.

<b>Persona të gjetur me emrat të cilat nuk ishin në listën e votuesve ku janë numëruar</b>	<b>650</b>
Emrat e tyre janë gjetur dikund tjetër në komunë	152
<b>Banorë të Kaçanikut që nuk janë në listë të votuesve</b>	<b>498</b>

Pjesa e mbetur, 498 votues të paregjistruar nuk u gjenden në asnjërën listë të verifikuesve. Këta individë mund të kenë ardhur për të jetuar në Kaçanik nga komuna tjera për shkak të arsyeve të ndryshme personale (p.sh martesë, mundësitë e punësimit, etj), përderisa zyrtarisht nuk kanë dokumentuar ndryshimin e tyre të vendbanimit. Një shpjegim më pak i besueshëm është që këta votues thjeshtë kurrë nuk janë regjistruar apo për ndonjë arsye janë hequr nga lista e votuesve. Fshatrat që kanë pasur numrin më të madh të votuesve të paregjistruar kanë përfshirë Kovaçecin (9%), Glloboçicën (7%) dhe Stagovën (7%).

## Rezultatet e filtruara

Për t'i vlerësuar më mirë burimet e parregullsive, baza e të dhënave ka mundur që të filtrojmë të dhënat në tri kategori. Ndarja e parë është bërë sipas lokacionit, duke i filtruar rezultatet e qendrave të votimit në zona rurale dhe ato urbane veçmas. Ndarja e dytë është bërë sipas llojit të dokumenteve të identifikimit, në mes të votuesve që kishin përdorur dokument identifikimi të UNMIK-ut dhe atyre që kanë nxjerrë dokumente personale të Kosovës. Ndarja e tretë është bërë sipas moshës, duke filtruar votuesit në ata nën moshën 70 vjeçare dhe ata mbi moshën 70 vjeçare. Më poshtë do të gjeni diskutimin mbi të gjeturat për të tre kategoritë.

### *Sipas lokacionit: dallimet urbane/rurale*

Është me rëndësi që të gjeturat e hulumtimit të analizohen në forma të ndryshme sipas lokacionit, veçanërisht për t'i krahasuar rezultatet e qytetit me ato të zonave rurale.

Popullsia me të drejtë vote e qytezës së Kaçanikut përbën rreth 30% të numrit të përgjithshëm të komunës (9.622 votues janë të regjistruar për të votuar pranë qendrave të votimit, 0701D dhe 0701X). Afër 63% të votuesve të regjistruar edhe në fakt jetojnë aty. Tre përqind jetojnë në fshatra tjera brenda komunës, 3% jetojnë jashtë Kaçanikut por brenda Kosovës dhe 17% jetojnë jashtë Kosovës. Rezulton se vetëm 2% nga lista e votuesve janë të vdekur.

Votuesit e zonave rurale janë të shpërndarë në 28 fshatra dhe numri i përgjithshëm i votuesve nga zonat rurale është 21.435. Katër fshatra afër qytetit votojnë në dy qendrat e votimit të përmendura më herët. Tabela e mëposhtme tregon një krahasimin të saktësisë së listave të votuesve në zonat urbane dhe rurale.



	Lokacioni si në listë të votuesve	Tjetër lokacion	Tjetër komunë	Jashtë Kosovës	Të vdekur	Nuk ka informata	Të parregjistruar
Rural	59%	5%	5%	21%	3%	7%	359
Kaçanik	63%	8%	3%	17%	2%	7%	139

Siç shihet më lartë, listat e fshatrave janë më pak të sakta. Ata kanë një shkallë më të lartë të mos-raportimit të vdekjeve (3% krahasuar me 2% në qytet) dhe një shkallë më të lartë të migrimit jashtë vendit (21% krahasuar me 17% në qytet).

Qyteti i Kaçanikut, krahasuar me vendet rurale, duket të ketë një numër relativisht më të lartë të votuesve që kanë lëvizur në pjesët tjera të komunës (8%). Qyteti ka një shkallë më të ulët të votuesve që jetojnë jashtë Kaçanikut por brenda Kosovës (3%). Pjesë e shpjegimit se pse një numër më i madh i votuesve nga zonat rurale jetojnë jashtë vendit apo në komuna të tjera është se qyteti ofron mundësi më të mira të arsimit dhe punësimit krahasuar me fshatrat e komunës. Për më shumë, qyteti ka kapacitete më të mëdha administrative për t'i regjistruar votuesit. Gjithashtu, banorët e qytetit ka më shumë të ngjarë të regjistrohen për të votuar, t'i regjistrojnë vdekjet apo të freskojnë statusin e tyre të banimit.

### ***Sipas llojit të letërnjoftimit***


Hulumtimi ka sjellë të gjetura interesante gjatë krahasimit të saktësisë së listave të votuesve në mes të votuesve që zotërojnë dokumente identifikimi të UNMIK-ut dhe atyre me dokumente identifikimi të Kosovës. Ndoshta nuk është befasues fakti se më shumë parregullsi janë hasur në mesin

e mbajtësve të dokumenteve identifikuese të UNMIK-ut (atyre që deri në verën e vitit 2012 ende nuk janë pajisur me dokumente të Kosovës). Vetëm 45% të votuesve me dokument identifikues të UNMIK-ut janë gjetur në të njëjtat lokalitete siç janë të regjistruar në qendra të votimit. Për krahasim, saktësia ishte 68% për mbajtësit e letërnjoftimeve të Kosovës.

---


### Kategoritë problematike sipas llojit të letërnjoftimit

---



Zbërthimi i kategorive problematike sipas llojit të letërnjoftimi

---



Përderisa vetëm 22% e mbajtësve të letërnjoftimeve të Kosovës kanë qenë pjesë e „kategorisë problematike“, kjo ka ndodhur me 43% të mbajtësve të letërnjoftimeve të UNMIK-ut.


Pas një shqyrtimi më të thellë të parregullsive nëpër kategori, në mes të dy llojeve të dokumenteve të identifikimit, të gjeturat tregojnë se kishte më shumë parregullsi tek votuesit me letërnjoftime të UNMIK-ut në secilën kategori. Mbajtësit e dokumenteve të UNMIK-ut më shpesh janë gjetur se jetojnë në lokalitete tjera në Kaçanik apo në komuna të tjera të Kosovës.

Duke iu referuar grafikoni të mëposhtëme, parregullsitë më të ndjeshme—përfshirë diasporën e Kosovës (26% kundër 16%) dhe personat e vdekur (6% kundër 1%)—po ashtu shënuan dallime të mëdha në mes të llojit të letërnjoftimeve. Një shifër shqetësuese në të dy kategoritë e të dy grupeve janë shifrat për personat që nuk ka informacion: që ishin 11% të personave me dokumente të UNMIK-ut dhe 5% me to të Kosovës.

### ***Sipas moshës***

Pas analizës së parregullsive sipas moshës, të gjeturat tregojnë që listat e votuesve janë 49% të sakta për votuesit e moshës mbi 70 vjeç (krahasuar me 61% për ata të moshës nën 70). Veç kësaj, 46% nga ata mbi 70 vjeçarë ishin në kategoritë problematike (krahasuar me 28% për ata nën moshën 70 vjeçare). Së fundmi, për 11% të votuesve nën moshën 70 vjeçare është gjetur që kanë lëvizur brenda Kosovës krahasuar me votuesit më pak lëvizës të moshës mbi 70 vjeçare, ku kjo shifër është 5%.

### Saktësia e listës së votuesve sipas moshës



## Tregim nga fshatra të zgjedhur

### Vatë/Dubravë

Vatë/Dubravë kanë numrin më të madh të votuesve të regjistruar në komunë, me 2.197 gjithsej. Qendra e votimit të këtij fshati po ashtu akomodon votuesit nga fshatrat Rekë, Vatë dhe një pjesë të fshatit Nikaj. Një karakteristikë e veçantë që e dallon këtë fshat nga fshatrat të tjerë të mëdha të kësaj komune është numri i lartë i votuesve të regjistruar që jetojnë jashtë vendit. Të gjeturat e hulumtimit tregojnë që më shumë se 29% të votuesve jetojnë jashtë vendit. Kjo është një nga arsyt kryesore se pse janë një numër i vogël i votuesve që jetojnë në të njëjtën adresë apo fshat (rreth 55%). Vetëm 5% të votuesve jetojnë në adresa të tjera në Kaçanik dhe rreth 3% në adresa jashtë Kaçanikut. Është identifikuar se 3% të votuesve të fshatit janë të vdekur.

### Begracë

Të regjistruar për të votuar në Begracë janë 1.801 persona, duke e bërë këtë fshat të dytin për nga numri i votuesve në

komunë. Çfarë është interesant, Begraca ka numrin më të madh të votuesve të regjistruar që edhe aktualisht jetojnë aty. Rreth 71% e votuesve të regjistruar në Begracë jetojnë në të njëjtën fshat siç paraqitet në listën e votuesve; rreth 2% jetojnë në ndonjë adresë tjetër në Kaçanik dhe 14% jetojnë jashtë vendit. Rreth 2% e votuesve akoma të regjistruar në këtë fshat raportohet se kanë të vdekur.

### Kaçanik i Vjetër

Sipas analizës sonë, 68% të votuesve të regjistruar në Kaçanik të Vjetër jetojnë në të njëjtën lokalitet, përderisa 5% jetojnë në ndonjë adresë tjetër brenda komunës së Kaçanikut. Përafërsisht 4% jetojnë jashtë komunës së Kaçanikut apo në ndonjë komunë tjetër, 13% jetojnë jashtë Kosovës dhe është gjetur që 3% janë të vdekur.

## **Saktësia e madhe në listë të votuesve tregon dalje më të lartë në zgjedhje**

Një listë e saktë e votuesve kryesisht kufizon manipulimet e votimit por ka efektin anësor që ndikon në saktësinë e raportimit të daljes në votime. Saktësia e listës së votuesve është e lidhur (ka korrelacion të lartë) me daljen në votime. Më hollësisht, me një listë të votuesve të pasaktë, elektorati duket të jetë më i madh se sa është aktualisht. Kjo është për arsyeje se kjo listë përfshin një numër të konsiderueshëm të votuesve të vdekur dhe të atyre që jetojnë jashtë vendit dhe praktikisht nuk kanë mundësi të votojnë.

Përfshirja e këtyre votuesve që nuk mund të votojnë nënvlerëson nivelin e vërtetë të pjesëmarrjes në zgjedhje, sepse këta thjesht konsiderohen votues të rregullt të cilët kanë zgjedhur që të mos votojnë.


Auditimi i listës së votuesve të Kaçanikut mund të dëshmon lidhjen në mes të saktësisë së listës së votuesve dhe pjesëmarrjes në zgjedhje. Për shembull, saktësia e lartë që u raportua, prej 70%, në Kaçanikun e Vjetër ka lidhshmëri me daljen e lartë në votime, prej 50%. Ndërkaq, Korbiliqi kishte saktësinë më të ulët të listës së votuesve, me 25%, dhe rrjedhimisht daljen më të vogël në votime, me më pak se 15%.

Grafikonët e mëposhtëm krahasojnë Kaçanikun i Vjetër me Korbiliqin si dy mostra ekstreme. Auditimi ka treguar se 30% të emrave të regjistruar në Kaçanik të Vjetër janë të atyre që ose jetojnë jashtë, kanë lëvizur brenda Kosovës ose janë të vdekur, pra që janë “jo-banues” (që nuk mund të votojnë fare). Në Korbiliq, 75% të emrave të regjistruar janë të tillë. Sa më i madh numri i ‘jo-banuesve’, aq më shumë emra dalin se nuk kanë votuar. Shkalla e lartë e pasaktësisë e krijon përshtypjen se ka votim të ulët edhe nëse nuk është rasti kështu.

---

### Kaçanik i Vjetër


---



---

### Korbiliq

---




---

Megjithëse disa nga shifrat mund të dallojnë nga trendi statistikor, korelacioni (raporti i drejtë) në mes të saktësisë së listës së votuesve dhe daljes në votime qartazi vihet re nga grafiku i mëposhtëm. Përmirësimi i listës së votuesve qartazi do të rriste saktësinë dhe dalja në zgjedhje do të raportohet si më e lartë. Ky raportim i përmirësuar do të përfaqësonte më mirë nivelin e pjesëmarrjes qytetare në zgjedhje dhe do të pasqyronte nivelin e legjitimitetit zgjedhor në vend.



**Korrelacion në mes të Daljes dhe Saktësisë së Listave të Votuesve**



## Përfundim dhe rekomandime

Auditimi i listës së votuesve në Kaçanik tregon një trend që reflekton listën e votuesve të të gjithë Kosovës. Lista e votuesve ka shumë mangësi, dhe nëse kjo nuk përmirësohet në të ardhmen e afërt, do të ketë një ndikim negativ në çdo proces zgjedhor të ardhshëm në vend. Shifra prej 40% e pasaktësisë në listë është shumë e lartë dhe krijon hapësirë për votim në emër të dikujt tjetër dhe për manipulim në rast se nuk ruhet një proces zgjedhor i lirë dhe i drejtë.

**Auditimi i Regjistrimit Civil:** Ka nevojë urgjente për një auditim gjithëpërfshirës të regjistrimit civil dhe listës së votuesve në një kornizë të gjerë institucionale. Ministria e Punëve të Brendshme edhe KQZ-ja janë përgjegjëse për mirëmbajtjen e regjistrave në formë të kompjuterizuar, dhe duhet të bashkëpunojnë me komunat për të azhuruar të dhënat. Përderisa KQZ-ja do të mund të bënte riparime të vogla, është më e dobishme nëse auditimi bëhet për të gjithë regjistrin civil në përgjithësi, meqenëse kjo do të përmirësonte listat e votuesve automatikisht.

**Votuesit nga diaspora të përfshihen në listë të veçantë:** Mbi 19% të votuesve të regjistruar në Kaçanik jetojnë jashtë vendit. Ata kanë të drejtë të jenë në listën e votuesve mirëpo duhet të argumentohet bartja e tyre në një listë të veçantë votuesish që do të mirëmbahej nga konsullatat jashtë vendit. Kjo zgjidhje është në pajtim me praktikën ndërkombëtare dhe lehtëson votimin e tyre në përfaqësitë tona diplomatike apo me postë.

**Raportimi më i mirë i vdekjeve:** Nuk është sfida e madhe për të pastruar emrat e personave të vdekur por problemi nuk qëndron vetëm në numrat aktual. Revidimi i praktikave dhe largimi i emrave të të vdekurve në mënyrë të rregullt në të ardhmen është edhe më me rëndësi. Kjo përfshin nevojën që qytetarët të jenë më të disiplinuar për të raportuar vdekjet e të afërmeve. Kërkohet një koordinim më i

mirë në mes të bashkësive fetare, komunave dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme e cila e mirëmban regjistrin civil.

**Përditësimi i adresave:** Individët që janë shpërngulur në ndonjë adresë tjetër brenda komunës ende mbeten në listën e votuesve por shumë nga ta nuk shkojnë për të votuar në qendra votimi nëse ato gjenden larg vendbanimit të tyre. Kjo ndodh posaçërisht nëse e marrin vesh këtë vetëm në ditën e zgjedhjeve, kur atyre iu tregohet që kanë ardhur në qendër të gabuar të votimit.

Personat të cilët janë shpërngulur jashtë komunës ende mbesin të regjistruar në fshatin e tyre të origjinës. Vetëm disa prej tyre dalin për të votuar në ditën e zgjedhjeve ndërsa të tjerë mund të votojnë në emër të tyre.

Statistikat e pasakta po ashtu kanë implikime buxhetore, që nënkupton buxhetimin më të vogël për disa komuna dhe buxhetimin më të madh të disa të tjerave. Edhe partitë duhet të shohin interesin e tyre dhe të kanalizojnë projektet aty ku banojnë më shumë jo vetëm në aspekt statistikor por me të vërtetë.

Dy kategoritë e fundit që përfshijnë lëvizjet e votuesve mund të adresohen vetëm përmes një projekti gjithëpërfshirës për të adresuar dhe përditësuar adresat individuale. Kjo është thelbësore meqenëse duket që ka konsensus për heqjen e votimit me kusht.





**Katalogimi në botim – (CIP)**

**Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës**

**657:342.82(496.51)**

**Auditimi i listës së votuesve të Kaçanikut : mostër për Kosovën / përgatitur nga Leon Malazogu, Visar Sutaj dhe Drilon Gashi. - Prishtinë : Demokracia për zhvillim, 2012. - 34 f. ; 21 cm.**

**1.Malazogu, Leon 2.Sutaj, Visar 3.Gashi, Drilon**

**ISBN 978-9951-608-03-9**



Demokraci për Zhvillim (D4D) është një institut hulumtues i themeluar në vitin 2010 nga një grup individë me përvojë dhe të kualifikuar të cilët u bashkuan me besimin se demokracia është parakusht për zhvillim. Themeluesit e D4D besojnë se demokracia është mjet dhe qëllim për zhvillim dhe janë të përkushtuar që të hulumtojnë dhe të përfshijnë një komunitet më të gjerë drejt këtij qëllimi.

Misioni i D4D-së është të ndikojë në proceset e zhvillimit të politikave publike në mënyrë që të përshpejtojë zhvillimin socio-ekonomik të vendit, përmirësimin e qeverisjes dhe për të përforcuar kulturën demokratike në Kosovë.

Për më shumë informata rreth aktiviteteve të D4D-së vizitoni faqen tonë elektronike: [www.d4d-ks.org](http://www.d4d-ks.org)



Kingdom of the Netherlands



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Federal Department of Foreign Affairs FDFA

ISBN 978-9951-608-03-9



9 789951 608039